

VENDIM
Nr.162, datë 18.3.2004

PËR PËRDORIMIN DHE KONTROLLIN E FONDIT PËR VEPRIMTARITË SPECIFIKE TË SHËRBIMIT INFORMATIV USHTARAK

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 13 të ligjit nr.9074, datë 29.5.2003 “Për Shërbimin Informativ Ushtarak”, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shërbimi Informativ Ushtarak të përdorë “Fondin specifik operativ (FSO)”, në lekë e valutë, që i vihet në dispozicion për realizimin e veprimtarive specifike, brenda fondeve të miratuara në buxhetin vjetor, për Ministrinë e Mbrojtjes.
2. Ky fond të përdoret për:
 - shpërblimin e burimeve të informacionit;
 - shpenzimet për sigurimin e informacionit;
 - blerjen në funksion të veprimtarive operative, me procedurën “Prokurim i drejtpërdrejtë”;
 - marrjen me qira të objekteve dhe të mjeteve, në funksion të veprimtarive operative.
3. Vlera e fondit për veprimtaritë specifike të jetë deri në 25 për qind të buxhetit vjetor të Shërbimit Informativ Ushtarak, vlerë kjo që miratohet nga Ministri i Mbrojtjes.
4. Kontrolli për shpenzimet e bëra ushtrohet, jo më pak se një herë në vit, nga personat e autorizuar nga Kryeministri.
5. Pika 12 e vendimit nr.122, datë 16.3.1992 të Këshillit të Ministrave “Për format, metodat dhe mjetet e punës të Shërbimit Informativ Ushtarak”, shfuqizohet.
6. Ngarkohet Ministri i Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano